



A.K.C.E
Nr. 61 Prot.
Datë 14.04.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 47, datë 12.4.2017

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike të jetë, gjithsej, 17 veta.

4. Urdhrat e Kryeministrit, nr.19, datë 14.2.2012, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike”, dhe nr.86, datë 11.7.2008, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik”, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe për vitin buxhetor 2017, organika e Autoritetit do të funksionojë e plotësuar brenda fondit për shpenzimet e personelit, të miratuar për këtë institucion.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



STRUKTURA E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE

